



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 233/2 Prot.

Tiranë, më 24.11.2016

V E N D I M
Nr. 146, datë 24.11.2016

**Mbi përfundimin e procedimit administrativ,
filluar me urdhrin e verifikimit nr. 233/1, datë 04.03.2016**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, "Kodi i Procedurave Administrative", si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit të dhënë prej Drejtorisë së Mbikëqyrjes, në lidhje me procedurën e verifikimit të kryer në Institucionin e Bashkisë Tiranë, për rastin e nëpunëses *****.

VËREJ SE,

Shkak për fillimin e kësaj procedure është bërë një ankesë e paraqitur nga nëpunësja ***** , protokolluar pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr. 233 prot., datë 01.03.2016, përmes së cilës pretendohet, se ndaj saj, në shkelje flagrante të ligjit, është vendosur lirimi nga shërbimi civil. Në kërkesë është parashtruar se nga ana e Bashkisë Tiranë, nuk janë respektuar kërkesat e ligjit 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 171, datë 26.3.2014, "Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil", pasi nuk është zbatuar procedura, si dhe vendimi i marrë për lirin e saj nga shërbimi civil, ka qenë i pajustificuar sepse nuk ka pasur shkurtim të vendit të punës.

Pas shqyrtimit paraprakisht të kërkesës, lidhur me përmbushjen e kriterëve formale ligjore, është urdhëruar fillimi i hetimit administrativ për rastin në fjalë. Me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen, është njoftuar institucioni Bashkia Tiranë, për fillimin e hetimit administrativ, duke kërkuar prej tyre, të vënë në administrim të Komisionerit, të gjitha aktet administrative që materializojnë procesin e ristrukturimit të institucionit si dhe procedurat e ndjekura për lirin nga shërbimi civil të nëpunëses *****.

Në përgjigje të kërkesës, me shkresën nr.19174/1, datë 03.12.2015, me lëndë “*Kthim përgjigje*”, institucioni ka informuar Komisionerin se, Bashkia Tiranë, në kuadër të riorganizimit për shkak të reformës territoriale, është përfshirë në proces ristrukturimi dhe aktualisht ka përfunduar vetëm sistemimi i punonjësve që janë pjesë e aparatit qendror, ndërkohë që ende nuk ka përfunduar ristrukturimi për të gjithë institucionin, pasi procesi është duke vijuar me sistemimin e njësive administrative, që janë pjesë e Bashkisë Tiranë.

Nisur nga dokumentacioni që është vënë në dispozicion prej Bashkisë Tiranë si dhe nga sa u analizua më sipër, Komisioneri vlerësoi se ky institucion ndodhej në kushtet e ristrukturimit, i cili ka filluar me miratimin e strukturës së re të institucionit, sipas Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, nr. 12620, datë 14.09.2015 “*Për miratimin e Strukturës dhe Organikës së Aparatit të Bashkisë Tiranë*” dhe ka vijuar me ngritjen e Komisionit të Ristrukturimit, sipas Urdhërit nr. 12889, datë 16.09.2015, të njësive përgjegjëse, përbërja e të cilit është në përputhje me nenin 50, të ligjit nr.152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Në këto rrethana, duke analizuar kërkesën e institucionit, si dhe duke vlerësuar faktet si më poshtë:

- Në kushtet kur, procesi i ristrukturimit, nuk kishte përfunduar dhe ende ekzistonte mundësia e risistemimit të punonjësve të liruar, në pozicionet e mbetura pa u prekur nga procesi;
- duke marrë parasysh nivelin e lartë të vështirësisë së procesit, ***së pari***, për shkak të numrit të madh të pozicioneve të punës dhe punonjësve që preken nga ristrukturimi, rreth 800 pozicione, ***së dyti*** për shkak të dokumentacionit voluminoz që do të merret në shqyrtim nga Komisioni i Ristrukturimit, i cili do të vijojë të shtohet deri në përfundim të procesit nga Njësia Përgjegjëse, si dhe për faktin se;
- Institucioni ishte brenda afateve të përcaktuara nga ligji nr. 8652, datë 31.07.2000 “*Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore*”, i ndryshuar dhe në Vendimin nr. 510, datë 10.06.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-teritorial*”, Kreu IV, për përfundimin e transferimit dhe pozicionimit në kohë të personelit;

Komisioneri, vlerësoi se në këtë rast, duhej t'i jepte kohën e nevojshme Komisionit të Ristrukturimit për të përfunduar riorganizimin e institucionit. Vetëm pas përfundimit të procesit nga strukturat kompetente, Komisioneri i krijohet mundësia për të verifikuar zbatimin e ligjshmërisë, gjatë zhvillimit të procedurave për implementimin e strukturës së re të Bashkisë Tiranë. Nisur nga sa më lart, me Vendimin nr. 129, datë 11.12.2015, Komisioneri, ka vendosur të pezullojë procesin e verifikimit të informacionit të ardhur nga kjo nëpunëse, deri në përfundim të procedurave të ristrukturimit të Bashkisë Tiranë. Në pikën 2 të këtij vendimi, është ngarkuar institucioni, të njoftojë me shkrim Komisionerin, për përfundimin prej tyre të procedurave të ristrukturimit, si dhe të dërgojë të gjitha aktet administrative që materializojnë procedurën e ristrukturimit, për të mundësuar vijimin e hetimit administrativ të rastit në fjalë.

Ndërkohë rezulton se, punonjësja ***** , krahas kërkesës drejtuar institucionit tonë, për të kundërshtuar urdhërin e lirit të tij nga shërbimi civil, i është drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës

Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, përmes së cilës është kërkuar prej saj, shfuqizimi i aktit administrativ nr. 3199 prot., datë 01.02.2016. Për këtë fakt, fillimisht u vumë në dijeni prej personit të ngarkuar nga institucioni i Bashkisë Tiranë për të komunikuar me Komisionerin, ***** dhe më pas është bërë verifikimi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila konfirmoi përmes vërtetimit të datës 08.09.2016, faktin se kërkesja e sipërcituar është në proces gjyqësor me Bashkinë Tiranë.

Në këto rrethana, vlerësoj se, referuar nenit 36 të Kodit të Procedurës Civile, i cili sanksionon parimin e moslejimit të shqyrtimit nga institucionet e tjera, të çështjeve që po trajtohen apo janë trajtuar nga sistemi gjyqësor, duhet të vendoset përfundimi i procedimit.

Për këto arsye:

Në mbështetje të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, “Kodi i Procedurave Administrative”, i ndryshuar, nenit 36 të “Kodit të Procedurës Civile” si dhe nenit 34 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A :

1. Përfundimin e procedimit administrativ, të nisur me Urdhërin e verifikimit nr. 233/1, datë 04.03.2016. “Për verifikimin e Aktit nr.3199 prot., datë 01.02.2016, të Bashkisë Tiranë”, për shkak se çështja është duke u trajtuar në gjykatë.
2. Të njoftohen për këtë vendim, institucioni i Bashkisë Tiranë si dhe kërkesja *****.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA